

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Avdi Dinaj, kryetar, Emine Mustafa dhe Nebojsha Boriçiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit I. H. nga Gjilani, për shkak të veprës penale heqja ose dëmtimi i vulave zyrtare nga neni 322 par.1 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga i dënuari kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjilan P.nr.936/2012 datë 02.03.2014, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.765/2014 datë 26.11.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 28.04.2016, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit I. H., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjilan P.nr.936/2012 datë 02.03.2014, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.765/2014 datë 26.11.2015.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gjilan P.nr.936/2012 datë 02.03.2014, i dënuari I. H., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare nga neni 322 par.1 të KPK, dhe për këtë veprë i është shqiptuar dënimi me kusht ashtu që gjykata i ka përcaktuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen veprë

tjetër penale, e në të kundërtën ai do të revokohet. E ka detyruar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej 20 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Ky aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.765/2014 datë 26.11.2015.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari I. H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim ose të ndryshohen ashtu që i njëjti të lirohet nga akuza.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtrësën KMLP.II.nr.67/2016 datë 13.04.2016, ka dhënë përgjigjen në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë duke propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë i dënuari edhe pse nuk i ka precizuar bazat juridike të këtij mjeti juridik, nga referati i saj rezulton se aktgjykimet kundërshtohen për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse aktgjykimi është në kundërshtim me përmbajtjen e procesverbaleve dhe shkresave të çështjes. Po ashtu theksohet se gjykata e shkallës së parë ka qenë e njëanshme, për faktin se është bërë ndryshimi-korrigjimi i mbrojtjes së të tij të dhënë në procedurë dhe siç precizohet në kërkesë “ndoshta janë hequr edhe provat nga shkresat e çështjes”. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson si të pabazuara pretendimet e mësipërme sepse janë të paqarta meqë nuk mund të kuptohet se ku konkretisht qëndrojnë ato shkelje.

Aktgjykimi i shkallës së parë nuk ka paqartësi në dispozitiv dhe në arsyetim, të dy aktgjykimet janë të qarta, në të janë dhënë arsye të qarta përkitazi me rrjedhjen e ngjarjes,

motivin dhe dashjen e të dënuarit për të kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtorë.

Nga shkresat e çështjes rezulton se i dënuari I. H. është shpallur fajtorë dhe dënuar, për shkak të veprës penale heqja ose dëmtimi i vulave zyrtare nga neni 322 par.1 të KPK.

Vendimin e saj gjykata e shkallës së parë e bazon në provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor në rradhë të parë deponimin e të dënuarit I. H. i cili nuk e ka mohuar faktin se e ka hequr vulën –bllobën e vendosur nga personat e autorizuar, si dhe nga prova tjera siç janë deponimi i dëshmitares N. K. përfaqësuesja e Kompanisë “Hidromorava” dhe prova tjera materiale, vërejtja para shkyçjes e dërguar të dënuarit e datës 07.06.2012, procesverbali mbi inspektim të cilin e ka firmosur edhe vet i dëmtuari me rastin e vënies së bllobës-vulës me numër 37 nga komisioni i të dëmtuarës më 05.07.2012 si dhe procesverbalin mbi inspektimin e bërë me datën 24.10.2012 kur është konstatuar dëmtimi i vulës zyrtare. Pra, të gjitha kotë prova në mënyrë të padyshimtë janë në përputhje të plotë edhe me mbrojtjen e të dënuarit I., i cili asnjëherë nuk e ka mohuar ekzistimin e borxhit ndaj të dëmtuarës si dhe faktin se e ka hequr bllobën e vendosur paraprakisht nga e dëmtuara. Prandaj konkludimet e dy gjykatave lidhur me zhvillimin e ngjarjes dhe cilësimin juridik të veprës penale është i drejt.

Pjesa tjetër e kërkesës ka të bëjë me shkeljen e ligjit penal në dëm të dënuarit e cila shkelje konsiston në atë se ai nuk ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtorë dhe gjykuar. Në kërkesë i dënuari potencon se kjo vepër penale i është montuar nga motivet e hakmarrjes, për faktin se i njëjti ujin e shpenzuar e kishte paguar në formë të paushallit dhe kështu është ngarkuar me dyfishin e çmimit të ujit. Sipas pretendimeve në kërkesë këtu kemi të bëjmë me raportin civilo juridik meqë ky kontest do të duhej të zgjidhej me marrëveshje në mes të palëve, e jo në procedurën penale siç ka ndodhur në rastin konkret. Theksohet se kompania “Hidro Morava” nga Gjilani nuk është institucion i autorizuar për dhënien e shenjave zyrtare, prandaj në veprimet e tij fare nuk qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, që i përket gjendjes faktike për çfarë nuk mund të ushtrohet ky mjet juridik.

Megjithatë, kjo Gjykatë vlerëson se siç edhe u elaborua më lart, me asnjë provë të administruar nuk vihet në dyshim përgjegjësia penale e të dënuarit përkitazi me veprën penale për të cilën është shpallur fajtorë dhe gjykuar, siç drejtë kanë konkluduar të dy gjykatat për çfarë kanë dhënë arsye të plota të cilat si të drejta dhe të ligjshme i pranon edhe kjo gjykatë.

Ndërsa, për sa i përket faktit lidhur me statusin-autorizimet e kompanisë “Hidro Morava”, kjo gjykatë vlerëson se kjo kompani është i vetmi institucion i autorizuar me ligj për ofrimin e shërbimeve për furnizimin e ujit dhe, ushtron kontroll mbi pajisjet e veta, në rastin konkret njehsorit për matjen e ujit të shpenzuar dhe se këtu kemi të bëjmë me Ndërmarrje Publike Rajonale të Ujitjes siç është përcaktuar me nenin 23 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit mbi ndërmarrjet Publike nr. 04/L-111 datë 20 prill 2012 ndërmarrje kjo e cila e ka statusin e personit juridik ashtu siç është paraparë nga dispozita e nenit 107 par.4 të KPK, (120 par.6 të KPK të aplikueshëm).

Nga arsyet e lartë cekura kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është refuzuar si e pa bazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SURPEME E KOSOVËS NË PRISHTINË

PML.nr.97/2016 datë 28.04.2016

Procesmbajtëse,  
Qefsere Berisha

Kryetar i kolegjit,  
Avdi Dinaj